



AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" KATER GRYKET " SHPK- BULQIZE

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " KATER GRYKET " ShPK , e perfaqesuar nga ortaku i vetem themelues SULEJMAN LALA, eshte person juridik me qender ne Bulqize.

Art. 1.

Te siperpermendurit vendosi te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin: "KATER GRYKET " ShPK, me seli ne adresen Qyteti i Ri Bulqize.

Art. 2.

Shoqeria " KATER GRYKET " ShPK eshte person juridik dhe veprimtaria e saj rregullohet sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi, Aktit te themelimit dhe Statutit.

Art. 3.

Shoqeria " KATER GRYKET " ShPK do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe mbi 10 vjet.

Art. 4.

Objekti i shoqerise "KATER GRYKET " ShPK eshte:

1. Ne fushen e ndertimit per punime per kategorite e specifikuara te punimeve si:

Kat.1- Punime dheu, murature, betoni, b/arme te zakonshme, punime shembjesh.

Kat.2- Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. e kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

Kat.3- Punime restaurimi

Kat.4- Yepra b/arme te vecanta

2. Ne fushen e transportit.

Art. 4.

Kapitali Themeltar i Shoqerise "KATER GRYKET" ShPK eshte 800.000 (telegind mije) leke

Art. 5.

Rregullat e shoqerise, jane pershkruar ne statutin bashkengjitur kesaj Kontrate

Art. 6.

Drejtimi i Shoqerise "KATER GRYKET" ShPK, do te behet nga Sulejman LALA, i cili do te jete Administrator i kesaj Shoqerie.

Tirene, 19.01.1993

THEMELUESI
SULEJMAN LALA

STATUTI

I

SHOQERISE ME PERQJEGJESI TE KUFIZUAR

"KATER GRYKET" BULOIZE (SHPK)



K R E U I *****

DISPOZITA TE PERQJITHSHE

NENI 1

Shoqeria me Per qjegjesi te Kufizuar " KATER GRYKET "Bulqize(SHPK) eshte person juridik i pavarur,ka te drejta dhe detyrime per te cilat per gjigjet brenda kufijve te percaktuar ne ligjin 7512 date 10.8.1991,Kodin Tregtar dhe akte te tjera ligjore.

NENI 2

Shoqeria "KATER GRYKET "SHPK BULOIZE ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tre gut te lire .

NENI 3

Themeluesi i Shoqerise "KATER GRYKET "SHPK Bulqize,ne kete sipers marrje ka derdhur kapitalin e tij,me qellim qe te fitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private,si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributia ne kapitalin themeltar.

NENI 4

Shoqeria "KATER GRYKET " SHPK BULOIZE,eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin e saj ne Gjykaten e rrethit Tirane dhe pajisjes me lejen e ushtrimit te profesionit nga Zyra e Tatimeve nen juridiksionin e se ciles eshte.

EMRI,QENDRA,TERRITORI

NENI 5

Emertimi i shoqerise do te jete:

SHOQERIA ME PERQJEGJESI TE KUFIZUAR "KATER GRYKET "BULOIZE(SHPK)

NENI 6

NENI 6

Selia e Shoqerise " KATER GRYKET "SHPK Bulqize eshte ne adresen

Oytati i Ri Bulqize.

Shoqeria "KATER GRYKET"SHPK Bulqize mund ta zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjitha territorin e Republikes se Shqiperise.

O B J E K T I**NENI 7**

Objekt i veprimtarise private te Shoqerise "KATER GRYKET"SHPK Bulqize do te jete:

- Ne fushen e ndertimit per punime per kategorite e specifikuara te punimeve si:

* Kat 1-punime dheu,murature,betoni,b/arme te zakonshme,punime shembjesh.

* Kat 2-ndertime civile ,industriale,turistike,bujqesore etj., e kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

* Kat 3-punime restaurimi.

* Kat 4-vepra b/arme te veganta.

- Ne fushen e transportit.

AFATI I VEPRIMTARISE**NENI 8**

Veprimtaria private e Shoqerise "KATER GRYKET" SHPK Bulqize,do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar mbi dhjete vjet.

NENI 9

Shoqeria eshte e detyruar te mos ndryshoje destinacionin e saj. Ndryshimi mund te behet me miratim.

KAPITALI I SHOQERISE**NENI 10**

Kapitali themeltar i Shoqerise "KATER GRYKET"SHPK Bulqize,perbehet nga kontributi fillestar i themeluesit te Shoqerise ne vlefte 800.000 leke (teteqind mije).Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te Shoqerise.

NENI 11

Zvoglimi i kapitalit themeltar ne nje vlere me te vogel se 100.000 leke e detyron shoqerine te shndrohet ne nje forme tjeter,ne rast se ajo nuk merr vendim per rritjen e kapitalit themeltar te pakten deri ne vleren e mesiperme.

NENI 12

Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial.Shoqeria apo te tretet duhet te respektojne keto transferime sap

t'i behen te ditura asaj.

NENI 13

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge transigimie. Ato mund t'u kalojne bashkeshorteve ,paraardheseve dhe pasardheseve.

NENI 14

Pjese e kapitalit themeltar mund t'i transferohen edhe personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri me pelqim te themeluesit te shoqerise. Ne rast te shtimit te numerit te ortakëve, me miratimin e shumices se ortakëve, qe perfaqsojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

NENI 15

Ne rast te shtimit te numerit te ortakëve, me marreveshje ,pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet tyre.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

NENI 16

Ortaku i vetem themelues ka ne kompetence:

- * Te miratoje programin e shoqerise, te hartoje raportin e administrimit, inventaret, llogaritë vjetore, te cilat hartohen brenda nje afati 6 muaj, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

- * Vendos per shperberjen e shoqerise.

- * Vendos per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve .

- * Rregullon marredheniet e punesimit e te shperblimit brenda shoqerise.

- * Sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shteterore, personave juridike e fizike vendas a te huaj.

- * E te tjera.

NENI 17

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " KATER GRUKET" (SHPK) Bulqize do te kete si administrator ortakun e vetem themelues s. Sulejman Lala. Themeluesi i Shoqerise ka ne kompetence te caktoje si administrator edhe persona te tjere, te cilet nuk e kane cilesine e ortakut.

NENI 18

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e veprimtarise se Shoqerise. Ai mund te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.

NENI 19

Ne marredhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine neper mjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Ne rastet kur administratori eshte i emeruar nga themeluesi i shoqerise, kryen te gjitha veprimet e administrimit te firmes, me perjashtim te atyre qe jane ne kompetencen e themeluesit te shoqerise.


NENI 20

Ne rast se administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator i zgjedhur posaqerisht nga ortaku themelues,ky i fundit miraton aktet e administrimit brenda afateve te mesiperme,dhe ka te drejte te informohet personalisht per veprimtarine e shoqerise,si dhe te njihet me llogarite dhe dokumentat e shoqerise.

NENI 21

Administratori humbet detyren e ngarkuar ne rast te prishjes se shoqerise,ose kur shkarkohet nga ortaku i vetu themelues i shoqerise.

Ne rastin e fundit,shkarkimi i administratorit behet ne base te nje akti me shkrim te themeluesit te shoqerise.Ne rast se shkarkimi behet pa te drejte,ai le shkak per demshperblim financiar.

K R E U I I

MARREDHENIRT EKONOMIKE FINANCIARE**NENI 22**

Shoqeria " KATER GRYKET " SHPK Bulqize mund te lidhe kontrata me sektoret shtetore,drejteperdrejt ne tregun e lire,si dhe me persona juridike e fizike vendas a te huaj,sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 23

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqsohet nga administratori i saj Sulejman Lala,ose persona te tjere te autorizuar prej tij.

NENI 24

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

NENI 25

Sipas rregullave te caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve te tjera ligjore,shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal,afatet e derdhjes se tij,detyrimet ndaj shtetit,sigurimet shoqerore,etj.Sipas ligjeve te tatimit mbi fitimin percaktohen tatimet per veprimtarine prodhuese dhe tregtare te shoqerise.

Shoqeria ka te drejte te qele llogari likujduese prane bankave te vendit,te huaja ne Shqiperi dhe te kryeje veprimet e likujdimit nepermjete tyre.

NENI 26

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike Shoqeria "KATER GRYKET" SHPK Bulqize ka te dre te te vetfinancohet ne leke ose valute te huaj.

NENI 27

Shkembimin e monedhes shqiptare me monedhe te huaj dhe anasjelltas mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shq.

ose ne tregun e lire privat te valutes.

NENI 28

Te ardhurat nga veprimtaria private, do te sigurohen sipas qmimeve e i cakton vete shoqeria. Qmimet dhe tarifat do te cektohen sipas kerkeses dhe ofertes.

NENI 29

Shoqeria ka te drejte te transferoje jashte shtetit kapitalin dhe pjesen e saj te fitimit ne valute. Per pjesen e fitimit qe transferohet jashte shoqeria paguan nje tatiu 10 perqind te shumes se fitimit qe transferohet.

NENI 30

Per pasqyrimin e aktivitetit, administratori ose persona te tjere te caktuar nga ortaku i vetem themelues, jane te detyruar qe mbajne dokumentacion te rregullt finaciar dhe regjistrat perkates sipas ligjit te veqante.

NENI 31

Veprimtaria ekonomike e shoqerise " KATER GRYKET " SHPK Bulqize, mbaron ne muajin dhjetor te qdo viti. Administratori eshte i detyruar te paraqese bilance periodike, bilance vjetore se bashku me deklaraten e fitimeve dhe humbjeve dhe t'i deponetoje ato ne organin financiar te juridiksionit perkates ku ushtron aktivitetin shoqeria.

K R E U III

MARREDHENIET E PUNESIMIT

NENI 32

Themeluesi i Shoqerise " KATER GRYKET " SHPK BULQIZE vendos per shtimin ose pakesimin e numerit te oratakeve dhe personave te tjere qe do te punesohen ne veprimtarine e Shoqerise " KATER GRYKET " SHPK Bulqize.

NENI 33

Marredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas kontrates qe lidhet lirisht midis paleve. Kontrata leshohet nga administratori i shoqerise, pasi te jete marre me pare pelqimi i themeluesit te shoqerise ose nga nga vete ortaku themelues qe ka edhe detyren e administratorit.

NENI 34

Marrja ne pune nga punedhenesi behet me rregjistrimin e punonjesve ne librin e punes te Shoqerise "KATER GRYKET " SHPK Bulqize si dhe duke njoftuar organet e punes te juridiksionit ku e ushtron aktivitetin shoqeria.

NENI 35

Ortaku i vetem themelues, ortaket ne rast se shtohet numri i tyre, administratori dhe punonjesit e tjere te Shoqerise "KATER GRYKET " SHPK Bul-

qisqejane te detyruar te respektojne disiplinën e punës dhe mbajne pergjegjesi per thyerjen e saj.

MENI 36

Ndaj personave qe demtojne pronën e Shoqërisë " KATER GRVKET" SHPK Bulqize sbatchen masa ndeshkimore te cilat percaktohen nga themeluesi i shoqërisë dhe ne mungese te tyre sbatchen dispozitat e Kodit te Punës te Republikës se Shqipërisë.

MENI 37

Kontrata e punës mund te lidhet me ose pa afat te caktuar, sipas kritereve te caktuara nga ortakut i vetem themelues ose nga ortakët kur jane dëna te tille dhe ne mungese te parashikimeve ne kontrate, sipas ligjeve te shtetit shqiptar.

MENI 38

Punonjesit gezojne lejen vjetore dhe leje plotesuese sipas kritereve te percaktuara ne kontraten e punës dhe ne mungese te tyre sipas kodit te Punës te Republikës se Shqipërisë.

MENI 39 Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga ortakut themelues z. Sulejman Lala. Largimi lidhet me nbarimin e kontrates se punës, per shkak te shkeljeve disiplinore ose ne vete kerkesen e te interesuarit.

MENI 40

Punonjesi qe largohet ose transferohet ne nje pune tjeter, duhet te beje dorëzimet e detyres ne baze te nje akti me shkrim, pasi te kete likuiduar detyrimet materiale dhe monetare. Akti i mesipermbahet nga administratoni i shoqërisë.

ELEMENTE TE TJERRA

MENI 41

Per zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë ekonomike prodhuese e ndertuese, transportuese tj. Shoqëria " KATER GRVKET " SHPK Bulqize mund te marre tralle per ndërtim me qira ose ne pronësi si dhe objekte te ndertuara sipas nje kontrate te vecante.

MENI 42

Dhenia e truallit ose e objekteve si dhe vlefte perkatëse e tyre percaktohen nga organi financiar nen juridiksionin e te cilit ndodhet trualli ose objektet ne baze te kritereve te Keshillit te Ministrave dhe sipas kerkeses e ofertes ne marreveshje me persona juridike e fizike vendas.

K R E U IV

BILANCI DHE TE ARDHURAT

MENI 43

Te ardhurat neto pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shqerore, etj., kalojne ne pr nesi te ortakut themelues ose te ortakëve ne s

ka te tille dhe ndahen sipas kontributit te secilit.

NENI 44

Shperblimi per administratorin dhe personat e punesuar ne veprimtarine e Shoqerise "KATER GRYKET" SHPK Bulqize, caktohet sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page vendoset nga themeluesi i Shoqerise, ose nga ortakët ne rast se shtohet numeri i tyre.

NENI 45

Shoqeria "KATER GRYKET" SHPK Bulqize perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre fillestar ne kapitalin baze.

NENI 46

Fitimi qe do te shperndahe t perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane sbritur ose shtuar shumat respektive te humbjeve apo fitimeve te bartura nga vitet e meparshme.

NENI 47

Kur pushon aktiviteti i Shoqerise "KATER GRYKET" SHPK Bulqize, kapitali i mbetur mbasi shlyen te gjitha detyrimet ndahen midis ortakëve sipas kontributit te secilit ose i mbetet ortakut te vetem themelues kur nuk ka te tjere.

NENI 48

Fitimi i mbetur kalon ne pronesi te ortakut te vetem themelues pasi jane shlyer te gjitha detyrimet tatimore, si dhe pagesat e mundesme per punonjesit e Shoqerise.

SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 49

Ne rast se kapitalet e shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortakut themelues vendos brenda kater muajve nga dita e konstatimit mbi mundesine e prishjes se parakohshme te Shoqerise dhe mund te kerkoje nga gjykata prishjen e saj.

NENI 50

Gjykata mund t'i afroje shoqerise nje afat maksimal prej gjashte muaj per te rregulluar gjendjen. Ajo nuk mund te prishe shoqerine ne rast se ky rregullim eshte bere ditën ne te cilen ajo mbledhet per te marre vendim.

NENI 51

Ne rast se Shoqeria nuk prishet, detyrohet te zvogloje kapitalin e saj ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur te pa mbuluar duke patur parasysh qe shumat e kapitalit te mbetur te jete mbi 100.000 lek.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 52

Themeluesi ne rastin e shtimit te numerit te ortakëve ka te drejten te beje ndryshimet e nevojshme ne statut, si dhe te hartoje edhe kontraten perbashket me ortakët e tjere, duke bere ndryshimet e nevojshme ne rregji-

trina-tregtar prane Gjykates se Brethit Tirane.

NENI 53

Mosmarreveshjet e Shoqerise ne marrredhenie me persona juridike e fi-
sike vendas a te huaj zgjidhen ne mirkuptim,ne te kunderten,kur kjo nuk
arrihet,zgjidhen nga gjykata.

NENI 54

Per sa s'eshte shprehur ne kete statut,i referohet ligjit 7512,date
10.08.1991,Kodit Tregtar te Republikes se Shqiperise dhe qdo akti tjeter
ligjor te legjislaconit shqiptar.

NENI 55

Statuti perpilohet ne kater kopje per t'iu dorozuar organeve kompet-
nte.Nje kopje e tij mbetet si pjese parberese e dokumentacionit te Shoqe-
rise me Pergjegjesi te Kufizuar " KATER GRYKET " SHPK Bulqize.

U nenshkrua ne Tirane,sot me daten 3.05.1993

THE M E L U E S I

SULEJMAN LALA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E DREJTESISE

N O T E R I A

NR. 46.75...REP.

NR. 1265...KOL.

V E R T F T I M

Vertetohet se sot me daten 19.1.1994 (nentedhjte e kater) ne
Zyren e Noterise Tirane u paraqit personalisht shtetasi Sulejman Lala
per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi personal,madhor
me notesi te plote per te vepruar,i cili deklaroi se statutin e Sho-
qerise me Pergjegjesi te Kufizuar "KATER GRYKET " SHPK Bulqize,e
krijon me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe e nenshkruan rre-
gullis t sipas ligjit'.



N O T E R E

Sulejman Lala
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 2350 Rep.

287

VERTETIM

Sot me daten 24/12 2006 para meje noteres u paraqit personalisht:

Z. Vera Lala, e bija e Fazlli, shtetase shqiptare, e lindur me 08.09.,1968 ne Tirane dhe banuese ne Tirane, rruga "S. Kolea", me cilesine e ekspertit, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, e cila me deklaroi se sa me siper eshte raporti i saj mbi rritjen e kapitalit te shoqerise "KATER GRYKET" SHPK dhe une noterja e vertetoj ate rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

Enaere Leraj

OK

